<p>6. Në lidhje me shërbimet e përmendura në nën-nënparagrafët 1.4.1 dhe 1.4.2 të këtij Neni, vetëm sa i përket transaksioneve të pagesave përmes kartelës së kreditit dhe nënparagrafit 1.4.3 të paragrafit 1 të këtij Neni, BQK mund të përcaktoj numrin minimal të operacioneve për të cilat banka mund të ngarkojnë vetëm tarifat e arsyeshme, nëse ka, të përmendura në Nenin 117 të këtij Ligji.</p> <p>6.1. BQK siguron që numri minimal i operacioneve është i mjaftueshëm për të mbuluar përdorimin personal të konsumatorit, duke marrë në konsideratë sjelljet ekzistuese të konsumatorit dhe praktikat e zakonshme të afarizmit;</p> <p>6.2. tarifat e ngarkuara për operacionet shtesë mbi numrin minimal të operacioneve, nuk duhet të jenë më të larta se ato të ngarkuara sipas politikës së zakonshme të çmimeve të bankës.</p> <p>7. Banka duhet të sigurojë që konsumatori të jetë në gjendje të menaxhojë dhe të iniciojë transaksionet e pagesave nga llogaria e pagesave me shërbime bazike e konsumatorit, në ambientet e bankës dhe nëpërmjet qasjes nga distanca/online, aty ku janë të disponueshme.</p> <p>8. Pa paragjykuar kërkesat tjera ligjore dhe rregullative të aplikueshme ndaj mbitërheqjeve, bankat mund të ofrojnë, me</p>	<p>6. With respect to the services referred to in 1.4.1, 1.4.2 only as regards payment transactions through a credit card and 1.4.3 of paragraph 1 of this Article, the CBK may determine a minimum number of operations for which banks can only charge the reasonable fees, if any, referred to in Article 117 of this Law.</p> <p>6.1. the CBK shall ensure that the minimum number of operations is sufficient to cover the personal use by the consumer, taking into account existing consumer behavior and common commercial practices;</p> <p>6.2. the fees charged for operations above the minimum number of operations shall never be higher than those charged under the usual pricing policy of the bank.</p> <p>7. Bank shall ensure that the consumer is able to manage and initiate payment transactions from the consumer's payment account with basic features in the banks' premises and via online facilities, where available.</p> <p>8. Without prejudice of other legal or regulatory requirements applicable to overdraft facilities, banks may provide,</p>	<p>6. Što se tiče usluga navedenih u podstavovima 1.4.1, 1.4.2 samo u pogledu platnih transakcija putem kreditne kartice i podstava 1.4.3 stava 1. ovog člana, CBK može odrediti minimalni broj radnji za koje banke mogu naplatiti samo razumne naknade, ako postoje, iz člana 117. ovog zakona.</p> <p>6.1. CBK obezbeđuje da minimalni broj radnji bude dovoljan da pokrije ličnu upotrebu od strane potrošača, uzimajući u obzir postojeće ponašanje potrošača i uobičajene komercijalne prakse;</p> <p>6.2. naknade koje se naplaćuju za radnje iznad minimalnog broja radnji nikada neće biti veće od onih koje se naplaćuju prema uobičajenoj politici određivanja cena od strane banke.</p> <p>7. Banka osigurava da potrošač može upravljati platnim transakcijama i pokretati ih sa računa za plaćanje potrošača sa osnovnim uslugama u prostorijama banke i putem online bankarstva, ako je ta mogućnost dostupna.</p> <p>8. Ne dovodeći u pitanje druge zakonske ili regulatorne zahteve koji se primenjuju na prekoračenja, banke mogu, na zahtev</p>
---	---	--

<p>kërkesën e konsumatorit, një mbitërheqje në lidhje me një llogari pagesash me shërbime bazike.</p> <p>8.1. BQK mund të përcaktojë një shumë maksimale dhe një kohëzgjatje maksimale të instrumentit të mbitërheqjes;</p> <p>8.2. qasja ose përdorimi i llogarisë së pagesave me shërbime bazike nuk do të kufizohet ose kushtëzohet nga blerja e këtyre shërbimeve kreditore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 117 Tarifat e ndërlidhura</p> <p>1. BQK siguron që shërbimet e përmendura në Nenin 116 të këtij Ligji ofrohen nga bankat pa tarife ose për një tarifë të arsyeshme, në mënyrë që të mundësohen kushte më të favorshme për kategori më të cenuara të konsumatorëve të cilët nuk posedojnë llogari bankare.</p> <p>2. BQK siguron që tarifat e aplikueshme ndaj konsumatorëve për mos-pajtueshmëri me zotimet e konsumatorëve të përcaktuara në kontratën kornizë, janë të arsyeshme.</p> <p>3. BQK përcakton tarifat e arsyeshme të referuara në paragrafët paraprakë duke marrë në konsideratë së paku nivelin e të ardhurave në vend dhe mesataren e tarifave</p>	<p>upon the customer's request, an overdraft facility in relation to a payment account with basic features.</p> <p>8.1. the CBK may define a maximum amount and a maximum duration of the overdraft facility;</p> <p>8.2. access to, or use of, the payment account with basic features shall not be restricted by, or made conditional on, the purchase of such overdraft facilities.</p> <p style="text-align: center;">Article 117 Associated fees</p> <p>1. The CBK shall ensure that the services referred to in Article 116 of this Law, are offered by banks free of charge or for a reasonable fee, allowing for more advantageous conditions for unbanked vulnerable consumers.</p> <p>2. The CBK shall ensure that the fees charged to consumers for non-compliance with the consumers' commitments laid down in the framework contract are reasonable.</p> <p>3. The CBK shall determine the reasonable fees referred to in the previous paragraphs taking into account as a minimum the national income level and the average fees</p>	<p>klijenta, obezbediti prekoračenje u vezi sa računom za plaćanje sa osnovnim uslugama.</p> <p>8.1. CBK može definisati maksimalan iznos i maksimalno trajanje prekoračenja;</p> <p>8.2. pristup korišćenju ili korišćenje računa za plaćanje sa osnovnim uslugama neće biti ograničeno ili uslovljeno kupovinom takvih prekoračenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 117 Povezane naknade</p> <p>1. CBK osigurava da usluge navedene u članu 116. ovog zakona banke nude besplatno ili uz razumnu naknadu, omogućavajući povoljnije uslove za osetljive grupe potrošače bez bankovnog računa.</p> <p>2. CBK osigurava da naknade koje se naplaćuju potrošačima za nepoštovanje obaveza potrošača utvrđenih okvirnim ugovorom budu razumne.</p> <p>3. CBK određuje razumne naknade iz prethodnih stavova, uzimajući u obzir kao minimum nivo nacionalnog dohotka i prosečne naknade koje naplaćuju banke u</p>
---	--	---

<p>të aplikuar nga bankat në Republikën e Kosovës për shërbimet e ofruara me llogaritë e pagesave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 118 Kontratat kornizë dhe ndërprerja</p> <p>1. Kontratat kornizë që ofrojnë qasje në llogarinë e pagesave me shërbime bazike i nënshtrohen Kapitullit III të Pjesës III të këtij Ligji, përveç nëse parashikohet ndryshe në paragrafët 2 dhe 4 të këtij Neni.</p> <p>2. Banka mund të ndërpresë në mënyrë të njëanshme një kontratë kornizë vetëm kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:</p> <p>2.1. konsumatori ka përdorur qëllimisht llogarinë e pagesave për qëllime të paligjshme;</p> <p>2.2. nuk ka asnjë transaksion në llogarinë e pagesave për më shumë se 24 muaj rresht;</p> <p>2.3. konsumatori ka dhënë informacion të pasaktë për të marrë llogarinë e pagesave me shërbime bazike ku informacioni i saktë do të kishte rezultuar në mungesën e një të drejte të tillë;</p>	<p>charged by banks in the Republic of Kosovo for services provided on payment accounts.</p> <p style="text-align: center;">Article 118 Framework contracts and termination</p> <p>1. Framework contracts providing access to a payment account with basic features shall be subject to the Chapter III of the Section III of this Law unless otherwise specified in paragraphs 2 and 4 of this Article.</p> <p>2. A bank may unilaterally terminate a framework contract only where at least one of the following conditions are met:</p> <p>2.1. the consumer deliberately used the payment account for illegal purposes;</p> <p>2.2. there has been no transaction on the payment account for more than 24 consecutive months;</p> <p>2.3. the consumer provided incorrect information in order to obtain the payment account with basic features where the correct information would have resulted in the absence of such a right;</p>	<p>Republici Kosovo za usluge koje se pružaju na računima za plaćanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 118 Okvirni ugovori i raskid</p> <p>1. Okvirni ugovori koji obezbeđuju pristup računu za plaćanje sa osnovnim uslugama podležu Poglavlju III Odeljka III ovog zakona, osim ako nije drugačije određeno u stavovima 2. i 4. ovog člana.</p> <p>2. Banka može jednostrano raskinuti okvirni ugovor samo ako je ispunjen najmanje jedan od sledećih uslova:</p> <p>2.1. potrošač je namerno koristio račun za plaćanje u nezakonite svrhe;</p> <p>2.2. nije bilo transakcije na računu za plaćanje više od 24 uzastopna meseca;</p> <p>2.3. potrošač je dao netačne podatke kako bi dobio račun za plaćanje sa osnovnim uslugama gde bi tačne informacije dovele do nepostojanja takvog prava;</p>
--	--	--

<p>2.4. konsumatori nuk është më banor i ligjshëm në Kosovë;</p> <p>2.5. konsumatori ka hapur më pas një llogari të dytë pagesash e cila i lejon atij të përdorë shërbimet e renditura në paragrafin 1 të Nenit 116 të këtij Ligji.</p> <p>3. BQK mund të identifikojë raste shitesë të kufizuara dhe specifike kur një kontratë kornizë për një llogari pagesash me shërbime bazike mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme nga bankat.</p> <p>3.1. raste të tilla do të bazohen në dispozitat ligjore në fuqi dhe do të synojnë shmangien e abuzimeve nga konsumatori të së drejtës së tyre për të siguruar qasje në një llogari pagesash me shërbime i bazike.</p> <p>4. Kur një bankë ndërpret kontratën për një llogari pagesash me shërbime bazike për një ose më shumë nga arsyet e përcaktuara në nënparagrafët 2.2, 2.4 dhe 2.5 të këtij Neni dhe në paragrafin 3 të këtij Neni, ai duhet të informojë konsumatorin për arsyet dhe justifikimin për ndërprerjen të paktën dy (2) muaj para hyrjes në fuqi të ndërprerjes, me shkrim dhe pa tarifë, përveç rasteve kur një shpalesje e tillë është e ndaluar me ligj ose vendim të një autoriteti publik.</p>	<p>2.4. the consumer is no longer legally resident in Kosovo;</p> <p>2.5. the consumer has subsequently opened a second payment account which allows him to make use of the services listed in paragraph 1 of Article 116 of this Law.</p> <p>3. The CBK may identify additional limited and specific cases where a framework contract for a payment account with basic features may be unilaterally terminated by the bank.</p> <p>3.1. such cases shall be based on applicable legal provisions and shall be aimed at avoiding abuses by consumers of their right to access a payment account with basic features.</p> <p>4. When a bank terminates the contract for a payment account with basic features on one or more of the grounds mentioned in subparagraphs 2.2, 2.4 and 2.5 of paragraph 2 and in paragraph 3 of this Article, it shall inform the consumer of the grounds and the justification for the termination at least two months before the termination enters into force, in writing and free of charge, unless such disclosure is prohibited by Law or order of a competent public authority.</p>	<p>2.4. potrošač više nije legalno nastanjen na Kosovu;</p> <p>2.5. potrošač je naknadno otvorio drugi račun za plaćanje koji mu omogućava da koristi usluge navedene u stavu 1. člana 116. ovog zakona.</p> <p>3. CBK može identifikovati dodatne ograničene i specifične slučajeve u kojima banka može jednostrano raskinuti okvirni ugovor za račun za plaćanje sa osnovnim uslugama.</p> <p>3.1. takvi slučajevi će se zasnivati na važećim zakonskim odredbama i imaće za cilj izbegavanje zloupotrebe od strane potrošača njihovog prava na pristup računu za plaćanje sa osnovnim uslugama.</p> <p>4. Kada banka raskine ugovor o računu za plaćanje sa osnovnim uslugama po jednom ili više osnova navedenih u podstavovima 2.2, 2.4 i 2.5 stava 2. i u stavu 3. ovog člana, obaveštava potrošača o razlozima i opravdanju za raskid najmanje dva meseca pre stupanja na snagu, pisanim putem i besplatno, osim ako bi takvo otkrivanje podataka bilo zabranjeno zakonom ili nalogom nadležnog organa javne vlasti.</p>
---	--	---

<p>4.1. kur banka ndërpret kontratën në përputhje me nënparagrafët 2.1 ose 2.3 të këtij Neni, ndërprerja do të hyjë në fuqi menjëherë.</p> <p>5. Njoftimi i ndërprerjes do të përmbaj edhe këshillën për konsumatorin mbi procedurën për të paraqitur një ankesë kundër ndërprerjes, nëse ka, dhe për të drejtën e konsumatorit për të kontaktuar BQK-në dhe për mundësinë e përdorimit të mekanizmit alternativ të zgjidhjes së mos marrëveshjeve, të përcaktuar me Kapitullin I të Pjesës VI të këtij Ligji, si dhe për të detajet përkatëse të kontaktit.</p>	<p>4.1. where the bank terminates the contract in accordance with subparagraphs 2.1 or 2.3 of paragraph 2, of this Article, the termination shall take effect immediately.</p> <p>5. The notification of termination shall advise the consumer of the procedure to submit a complaint against the termination, if any, and of the consumer's right to contact the CBK and make use of the relevant dispute resolution mechanisms provided for in the Chapter I of the Section VI of this Law and provide the relevant contact details.</p>	<p>4.1. kada banka raskine ugovor u skladu sa podstavom 2.1. ili 2.3. stava 2. ovog člana, raskid stupa na snagu odmah.</p> <p>5. Obaveštenjem o raskidu potrošač se savetuje o postupku podnošenja žalbe na raskid, ako postoji, i o pravu potrošača da stupi u kontakt sa CBK-om i koristi relevantne mehanizme za rešavanje sporova predviđene u Poglavlju I Odeljka VI ovog zakona i pružaju mu se relevantni kontakt podaci.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 119 Informacioni i përgjithshëm mbi llogaritë e pagesave me shërbime bazike</p>	<p style="text-align: center;">Article 119 General information on payment accounts with basic features</p>	<p style="text-align: center;">Član 119 Opšte informacije o računima za plaćanje sa osnovnim uslugama</p>
<p>1. BQK-ja do të sigurojë marrjen e masave adekuate për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për disponueshmërinë e llogarive të pagesave me shërbime bazike, kushtet e tyre të përgjithshme të çmimeve, procedurat që duhen ndjekur për të ushtruar të drejtën për të pasur qasje në një llogari pagesash me shërbime bazike dhe metodat për të pasur qasje në procedurat alternative të adresimit të mosmarrëveshjeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.</p>	<p>1. The CBK shall ensure that adequate measures are in place to raise awareness among the public about the availability of payment accounts with basic features, their general pricing conditions, the procedures to be followed in order to exercise the right to access a payment account with basic features and the methods for having access to alternative dispute resolution procedures for the settlement of disputes.</p>	<p>1. CBK osigurava da su na snazi adekvatne mere za podizanje svesti javnosti o dostupnosti računa za plaćanje sa osnovnim uslugama, njihovim opštim uslovima određivanja cena, procedurama koje treba slediti kako bi se ostvarilo pravo pristupa na otvaranje i korišćenje računa za plaćanje sa osnovnim uslugama i metodama pristupa alternativnim postupcima za rešavanje sporova radi.</p>
<p>1.1. BQK siguron që masat e</p>	<p>1.1. the CBK shall ensure that</p>	<p>1.1. CBK osigurava da mere</p>

<p>komunikimit të jenë të mjaftueshme dhe të synuara mirë, në veçanti duke iu drejtuar konsumatorëve të përjashtuar financiarisht, të cenueshëm dhe përdoruesve mobil të shërbimeve të pagesave.</p> <p>2. Bankat do të vënë në dispozicion të konsumatorëve, pa pagesë, informacion të qasshëm dhe ndihmë në lidhje me veçoritë specifike të llogarive të pagesave me shërbime bazike që ofrohen, tarifat shoqëruese të tyre dhe kushtet e përdorimit. Informacioni i dhënë do të bëjë të qartë se blerja e shërbimeve shtesë nuk është e detyrueshme për të pasur qasje në një llogari pagesash me shërbime bazike.</p> <p style="text-align: center;">PJESA VI ANKESAT, ZGJIDHJET ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJEVE, SHKELJET DHE NDËSHKIMET ADMINISTRATIVE</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI I PROCEDURAT E ANKESAVE DHE TË ZGJIDHJES ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJEVE</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli I Procedurat e Ankesës</p> <p style="text-align: center;">Neni 120 Ankesat</p>	<p>communication measures are sufficient and well-targeted, in particular reaching out to the financially excluded, vulnerable and mobile payment service users.</p> <p>2. Banks shall make available to consumers, free of charge, accessible information and assistance about the specific features of the payment account with basic features on offer, their associated fees and the conditions of use. The information provided shall make clear that the purchase of additional services is not compulsory in order to access a payment account with basic features.</p> <p style="text-align: center;">SECTION VI COMPLAINTS, ALTERNATIVE DISPUTE RESOLUTION, OFFENSES AND ADMINISTRATIVE PENALTIES</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER I COMPLAINT AND ALTERNATIVE DISPUTE RESOLUTION PROCEDURES</p> <p style="text-align: center;">SUBCHAPTER I COMPLAINT PROCEDURES</p> <p style="text-align: center;">Article 120 Complaints</p>	<p>komunikacije budu dovoljne i dobro ciljane, posebno da dopru do finansijski isključenih, ranjivih korisnika i korisnika usluga mobilnog plaćanja.</p> <p>2. Banke potrošačima besplatno stavljaju na raspolaganje dostupne informacije i pomoć u vezi sa posebnim uslugama koje se nude u okviru računa za plaćanje sa osnovnim uslugama, o naknadama za njihovo korišćenje i o uslovima korišćenja. Dostavljene informacije će jasno pokazati da kupovina dodatnih usluga nije obavezna za pristup računu za plaćanje sa osnovnim uslugama.</p> <p style="text-align: center;">ODELJAK VI PRITUŽBE, ALTERNATIVNO REŠAVANJE SPOROVA, PREKRŠAJI I ADMINISTRATIVNE KAZNE</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE I POSTUPCI ZA PODNOŠENJE PRITUŽBE I ALTERNATIVNO REŠAVANJE SPOROVA</p> <p style="text-align: center;">POTPOGLAVLJE I POSTUPCI ZA PODNOŠENJE PRITUŽBE</p> <p style="text-align: center;">Član 120 Pritužbe</p>
---	--	--

<p>1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vendosin procedura të formalizuara për paraqitjen e ankesave tek ofruesi i shërbimeve të pagesave nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave, dhe palët e tjera të interesuara duke përfshirë shoqatat e konsumatorëve për çështjet e mbuluara me këtë ligj.</p> <p>2. Procedurat e ankesës të përcaktuara në paragrafin paraprak duhet të përfshijnë të drejtën e përdoruesve të shërbimit të pagesave dhe palëve të tjera të interesuara, duke përfshirë shoqatat e konsumatorëve, për ta adresuar ankesën në BQK.</p> <p>3. BQK do të miratojë procedurat e nevojshme për t'u lejuar përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë shoqatat e konsumatorëve, të paraqesin ankesa drejtpërdrejtë në BQK në lidhje me shkeljet e pretenduara të këtij Ligji nga ofruesit e shërbimeve të pagesave.</p> <p>4. Pa cenuar të drejtën për të ngritur procedim përpara gjykatës në përputhje me legjislacionin në fuqi, përdoruesit e shërbimit të pagesave do të kenë qasje në procedurat e mekanizmave për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të përcaktuara në përputhje me Nenin 121 të këtij Ligji.</p>	<p>1. The payment service providers shall establish formalized procedures for the submission of complaints to the payment service provider by payment service users, and other interested parties including consumer associations of matters covered by this Law.</p> <p>2. The complaint procedures referred to in the previous paragraph must include the right of payment service users and other interested parties including consumer associations, to refer the complaint to the CBK.</p> <p>3. The CBK shall adopt the necessary procedures to allow payment service users and other interested parties including consumer associations, to submit complaints directly to the CBK with regard to payment service providers' alleged infringements of this Law.</p> <p>4. Without prejudice to the right to bring proceedings before a court in accordance with the applicable Law, payment service users shall have access to the alternative dispute resolution mechanisms procedures set up in accordance with Article 121 of this Law.</p>	<p>1. Pružaoci platnih usluga uspostavlja formalne procedure za podnošenje pritužbi pružaocu platnih usluga od strane korisnika platnih usluga i drugih zainteresovanih strana, uključujući udruženja potrošača o pitanjima obuhvaćenim ovim zakonom.</p> <p>2. Postupci za podnošenje pritužbe iz prethodnog stava moraju uključiti pravo korisnika platnih usluga i drugih zainteresovanih strana, uključujući udruženja potrošača, da podnesu pritužbu CBK-u.</p> <p>3. CBK usvaja neophodne procedure kako bi omogućio korisnicima platnih usluga i drugim zainteresovanim stranama, uključujući udruženja potrošača, da podnesu pritužbu direktno CBK-u u vezi sa navodnim kršenjem ovog zakona od strane pružaoca platnih usluga.</p> <p>4. Ne dovodeći u pitanje pravo na pokretanje postupka pred sudom u skladu sa važećim zakonom, korisnici platnih usluga imaju pristup alternativnim mehanizmima za rešavanje sporova utvrđenim u skladu sa članom 121. ovog zakona.</p>
---	--	---

<p>5. BQK mund të nxjerrë udhëzime apo rregullore për zbatimin e procedurave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli II Zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve</p> <p style="text-align: center;">Neni 121 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve</p> <p>1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të vendosin dhe zbatojnë procedura adekuate dhe efektive për zgjidhjen e ankesave të përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga Pjesët III, IV dhe V të këtij Ligji.</p> <p>2. Procedurat e përmendura në paragrafin paraprak do të jenë të disponueshme në gjuhën zyrtare ose në një gjuhë tjetër nëse bihet dakord shprehimisht ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe përdoruesit të shërbimit të pagesave.</p> <p>3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për t'iu përgjigjur ankesave të përdoruesve të shërbimit të pagesave, në letër ose, nëse bihet dakord ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe përdoruesit të shërbimit të</p>	<p>5. The CBK may issue guidelines or regulations for the implementation of the procedures referred to in paragraph 1 of this Article.</p> <p style="text-align: center;">SUBCHAPTER II ALTERNATIVE DISPUTE RESOLUTION</p> <p style="text-align: center;">Article 121 Dispute resolution</p> <p>1. Payment service providers shall put in place and apply adequate and effective complaint resolution procedures for the settlement of complaints of payment service users concerning the rights and obligations arising under Sections III, IV, and V of this Law.</p> <p>2. The procedures referred to in the previous paragraph shall be available in official language or in another language if expressly agreed between the payment service provider and the payment service user.</p> <p>3. Payment service providers shall make every possible effort to reply, on paper or, if agreed between the payment service provider and the payment service user, on another durable medium, to the payment service users' complaints.</p>	<p>5. CBK može izdati smernice ili propise za sprovođenje postupaka iz stava 1. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">POTPOGLAVLJE II ALTERNATIVNO REŠAVANJE SPOROVA</p> <p style="text-align: center;">Član 121 Rešavanje sporova</p> <p>1. Pružaoci platnih usluga uspostavljaju i primenjuju adekvatne i efikasne postupke rešavanja pritužbi za rešavanje pritužbi korisnika platnih usluga u vezi sa pravima i obavezama koje proizilaze iz Odeljaka III, IV i V ovog zakona.</p> <p>2. Postupci iz prethodnog stava biće dostupni na službenom jeziku ili na drugom jeziku ako je izričito dogovoreno između pružaoca platnih usluga i korisnika platnih usluga.</p> <p>3. Pružaoci platnih usluga ulažu sve moguće napore da odgovore, na papiru ili, ako je dogovoreno između pružaoca platnih usluga i korisnika platnih usluga, na drugom trajnom nosaču podataka, na pritužbe korisnika platnih usluga.</p>
---	--	---

<p>pagesave, në një mjet tjetër të qëndrueshëm.</p> <p>4. Përgjigja e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përcaktuar në paragrafin paraprak do të adresojë të gjitha pikat e ngritura, brenda një afati kohor adekuat dhe më së voni brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës nga marrja e ankesës.</p> <p>4.1. në situata të jashtëzakonshme, nëse përgjigja nuk mund të jepet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës për arsye jashtë kontrollit të ofruesit të shërbimit të pagesave, kërkohet që të dërgohet një përgjigje për pritje, duke treguar qartë arsyet e vonësës për përgjigje ndaj ankesës dhe duke specifikuar afatin deri në të cilin përdoruesi i shërbimit të pagesave do të marrë përgjigjen përfundimtare;</p> <p>4.2. në çdo rast, afati për marrjen e përgjigjes përfundimtare nuk do të kalojë tridhjetë e pesë (35) ditë pune.</p> <p>5. Ofruesi i shërbimeve të pagesave do të informojë përdoruesin e shërbimit të pagesave për të drejtën për të adresuar mosmarrëveshjen në BQK dhe çdo procedurë në fuqi për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve për të trajtuar mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga Pjesët III, IV dhe V të këtij Ligji.</p>	<p>4. The payment service provider's reply referred to in the previous paragraph shall address all points raised, within an adequate timeframe and at the latest within fifteen (15) business days of receipt of the complaint.</p> <p>4.1. in exceptional situations, if the answer cannot be given within fifteen (15) business days for reasons beyond the control of the payment service provider, it shall be required to send a holding reply, clearly indicating the reasons for a delay in answering to the complaint and specifying the deadline by which the payment service user will receive the final reply;</p> <p>4.2. in any event, the deadline for receiving the final reply shall not exceed thirty-five (35) business days.</p> <p>5. The payment service provider shall inform the payment service user about the right to refer the dispute to the CBK and any alternative dispute resolution procedures in place to deal with disputes concerning the rights and obligations arising under Sections III, IV, and V of this Law.</p>	<p>4. Odgovor pružaoca platnih usluga iz prethodnog stava se odnosi na sve navedene primedbe i pruža se u odgovarajućem vremenskom roku, a najkasnije u roku od petnaest (15) radnih dana od prijema pritužbe.</p> <p>4.1. u izuzetnim situacijama, ako se odgovor ne može dati u roku od petnaest (15) radnih dana iz razloga koji su izvan kontrole pružaoca platnih usluga, zahteva se slanje privremenog odgovora u kojem se jasno navode razlozi kašnjenja odgovora na pritužbu i rok do kojeg će korisnik platnih usluga primiti konačan odgovor;</p> <p>4.2. u svakom slučaju, rok za primanje konačnog odgovora neće biti duži od trideset pet (35) radnih dana.</p> <p>5. Pružalac platnih usluga obaveštava korisnika platnih usluga o pravu da uputi spor CBK-u i o svim alternativnim postupcima rešavanja sporova koji su na snazi za rešavanje sporova u vezi sa pravima i obavezama koje proizilaze iz Odeljaka III, IV i V od ovog zakona.</p>
--	--	--

<p>6. Informacioni i përcaktuar në paragrafin 5 të këtij Neni do të përmendet në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të qasshme në faqen e internetit të ofruesit të shërbimit të pagesave, aty ku ekziston, në degë dhe në kontratën kornizë ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe përdoruesit të shërbimit të pagesave. Ai do të specifikojë se si mund të arrihet në informacione të mëtejshme mbi procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.</p> <p>7. BQK mund të nxjerr udhëzime apo rregullore për zbatimin e dispozitave të këtij Neni, kjo përfshin rregullat mbi procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të cilat janë më të favorshme për përdoruesit e shërbimeve të pagesave se sa ato të përcaktuara në këtë nen.</p>	<p>6. The information referred to in the previous paragraph shall be mentioned in a clear, comprehensive and easily accessible way on the website of the payment service provider, where one exists, at the branch, and in the framework contract between the payment service provider and the payment service user. It shall specify how further information on alternative dispute resolution procedures can be accessed.</p> <p>7. The CBK may issue guidelines or regulations for the implementation of the provisions of this Article, this includes the introduction of rules on dispute resolution procedures that are more advantageous to the payment service user than those referred to in this Article.</p>	<p>6. Informacije iz prethodnog stava navode se na jasan, sveobuhvatan i lako dostupan način na veb stranici pružaoca platnih usluga, gde postoji, u podružnici i u okvirnom ugovoru između pružaoca platnih usluga i korisnika platnih usluga. Njime se navodi kako se može pristupiti daljim informacijama o alternativnim postupcima rešavanja sporova.</p> <p>7. CBK može izdati smernice ili propise za sprovođenje odredbi ovog člana, što uključuje uvođenje pravila o postupcima rešavanja sporova koji su korisniji za korisnika platnih usluga od onih navedenih u ovom članu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 122 Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve</p> <p>1. BQK do të rregullojë, përcaktojë ose promovojë vendosjen e procedurave adekuate, të pavarura, të paanshme, transparente dhe efektive të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, duke u bazuar dhe marrë në konsideratë dispozitat ekzistuese ligjore që mbulojnë zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve</p>	<p style="text-align: center;">Article 122 Alternative dispute resolution procedures</p> <p>1. The CBK shall regulate, establish or promote the establishment of adequate, independent, impartial, transparent and effective alternative dispute resolution procedures, based on and taking into consideration any existing legal provisions covering alternative dispute resolution and financial consumer protection, for the settlement of disputes between payment</p>	<p style="text-align: center;">Član 122 Alternativni postupci rešavanja sporova</p> <p>1. CBK reguliše, uspostavlja ili promoviše uspostavljanje adekvatnih, nezavisnih, nepristrasnih, transparentnih i efikasnih procedura za alternativno rešavanje sporova, na osnovu i uzimajući u obzir sve postojeće zakonske odredbe koje pokrivaju alternativno rešavanje sporova i finansijsku zaštitu potrošača, za rešavanje sporova između korisnika platnih usluga i</p>

<p>financiare, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga Pjesët III, IV dhe V të këtij Ligji.</p> <p>2. Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të përcaktuara në paragrafin paraprak do të zbatohen për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe gjithashtu do të mbulojnë aktivitetet e atyre që në mënyrë efektive kontrollojnë dhe administrojnë biznesin e ofruesit të shërbimeve të pagesave.</p> <p>3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave ju ofrojnë përdoruesve të shërbimeve të pagesave informatat të së paku një zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve për mosmarrëveshjet e konsumatorëve, të cilat duhet të përfshijnë adresën e faqes së internetit the autoritetin kompetent për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të përcaktuara nga ofruesi i shërbimit të pagesave.</p> <p>4. Të drejtat e përdoruesi të shërbimeve të pagesave të përcaktuara në paragrafët paraprak të këtij Neni nuk duhet të cenojnë të drejtat e tyre për iniciimin e procedurave gjyqësore ose cilat do të drejta ose mbrojtje ligjore që ju jep Ligji.</p> <p>5. BQK do të bashkëpunojë në mënyrë efektive me subjektet e huaja për zgjidhjen</p>	<p>service users and payment service providers concerning the rights and obligations arising under Sections III, IV, and V of this Law.</p> <p>2. The alternative dispute resolution procedures referred to in the previous paragraph shall be applicable to all payment service providers and shall also cover the activities of those who effectively control and administer the business of payment service providers.</p> <p>3. The payment service providers shall provide the payment service users with information of at least one alternative dispute resolution for consumer disputes, which shall include the website address and the competent authority for the alternative dispute resolution referred at by the payment service provider.</p> <p>4. The rights of payment service users referred to in the previous paragraphs of this Article shall not affect their rights to initiate court proceedings or any other rights or legal protections granted by Law.</p> <p>5. The CBK shall cooperate effectively with competent foreign entities for the</p>	<p>pružalaca platnih usluga u vezi sa pravima i obavezama iz Odeljaka III, IV i V ovog zakona.</p> <p>2. Alternativni postupci rešavanja sporova iz prethodnog stava primenjivaće se na sve pružaoce platnih usluga, a pokrivaju i aktivnosti onih koji efektivno kontrolišu i upravljaju poslovanjem pružalaca platnih usluga.</p> <p>3. Pružaoци platnih usluga dužni su da korisnicima platnih usluga pruže informacije o najmanje jednom alternativnom rešavanju sporova za potrošačke sporove, što uključuje adresu veb stranice i nadležnog organa za alternativno rešavanje sporova na koji se poziva pružalac platnih usluga.</p> <p>4. Prava korisnika platnih usluga iz prethodnih stava ovog člana ne utiču na njihovo pravo na pokretanje sudskog postupka niti na druga prava ili zakonske zaštite predviđene zakonom.</p> <p>5. CBK efikasno saraduje sa nadležnim stranim subjektima za rešavanje</p>
--	--	--

<p>e mosmarrëveshjeve ndërkufitare lidhur me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga Pjesët III, IV dhe V të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI II DISPOZITAT PENALE, SHKELJET DHE NDËSHKIMET ADMINISTRATIVE</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli I Dispozitat penale</p> <p style="text-align: center;">Neni 123 Dispozitat penale</p> <p>Kushdo që ushtron veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve të pagesave apo emetimit të parave elektronike në kundërshtim me nenet 28 dhe 35 të këtij Ligji, pa marr autorizimin relevantë apo përjashtimin e aplikueshëm siç përcaktohet me këtë ligj, përben vepër penale dhe do të jetë përgjegjës për burgim për një afat që nuk tejkalon tre (3) vite.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli II Shkeljet administrative</p> <p style="text-align: center;">Neni 124 Shkeljet dhe ndëshkimet administrative</p> <p>1. Shkeljet e dispozitave të këtij Ligji dhe</p>	<p>resolution of cross-border disputes concerning the rights and obligations arising under the Sections III, IV, and V of this Law.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II PENAL PROVISION, ADMINISTRATIVE OFFENSES AND ADMINISTRATIVE PENALTIES</p> <p style="text-align: center;">SUBCHAPTER I PENAL PROVISION</p> <p style="text-align: center;">Article 123 Penal provision</p> <p>Whoever exercises the activities of provision of payment services or issuance of electronic money in violation of Articles 28 and 35 of this Law, without the relevant authorization or applicable exemption as provided for in this Law, commits a criminal offense and shall be liable to imprisonment for a term not exceeding three (3) years.</p> <p style="text-align: center;">SUBCHAPTER II ADMINISTRATIVE OFFENSES</p> <p style="text-align: center;">Article 124 Administrative offenses and penalties</p> <p>1. An infringement to the provisions of this</p>	<p>prekograničnih sporova u vezi sa pravima i obavezama koje proizilaze iz Odeljaka III, IV i V ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II KAZNE NE ODREDBE, ADMINISTRATIVNI PREKRŠAJI I ADMINISTRATIVNE KAZNE</p> <p style="text-align: center;">POTPOGLAVLJE I KAZNE NE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 123 Kaznena odredba</p> <p>Ko obavlja delatnost pružanja platnih usluga ili izdavanja elektronskog novca suprotno članovima 28. i 35. ovog zakona, bez odgovarajućeg ovlašćenja ili primenjivog izuzeća predviđenog ovim zakonom, čini krivično delo i kazniće se kaznom zatvora u trajanju do tri (3) godine.</p> <p style="text-align: center;">POTPOGLAVLJE II ADMINISTRATIVNI PREKRŠAJI</p> <p style="text-align: center;">Član 124 Administrativni prekršaji i kazne</p> <p>1. Kršenje odredbi ovog zakona ili bilo kog</p>
--	---	---

<p>akteve nën ligjore të BQK-së, në zbatim të tij, siç përcaktohet me këtë nen, konsiderohen si shkelje administrative dhe BQK ka të drejtë të vendosë gjoba ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave, institucioneve të parave elektronike ose ndaj personave fizik ose juridik relevant siç përcaktohet me paragrafët në vijim të këtij Neni.</p> <p>2. BQK vendosë gjobë nga 500 Euro deri në 25,000 Euro për ofruesin e shërbimeve të pagesave ose institucioneve të parave elektronike që kryen një nga shkeljet në vijim:</p> <p>2.1. dështon t'i plotëson kërkesat për kapitalin minimal, siç përcaktohet në këtë ligj dhe nga BQK;</p> <p>2.2. shkelë ndonjë prej rregullave lidhur me mbrojtjen e fondeve të përcaktuara me nenet 11 dhe 33 të këtij Ligji;</p> <p>2.3. ka dështuar të krijoj rregulla adekuate dhe gjithëpërfshirëse të auditimit të kërkuara me paragrafin 2 të Nenit 12 dhe paragrafin 1 të Nenit 29 të këtij Ligji;</p> <p>2.4. nuk njofton BQK-në për ndonjë zhvillim të e ri madhor siç përcaktohet në Nenin 17 të këtij Ligji;</p>	<p>Law or any other secondary legislation issued by the CBK for its implementation, as provided for in this Article, shall be considered as an administrative offense and the CBK has the power to impose penalties to the payment service provider, electronic money institution or other relevant natural or legal persons as established in the following paragraphs of this Article.</p> <p>2. The CBK shall impose a penalty of EUR 500 to EUR 25,000 on the payment service provider or electronic money institution that commits any of the following offenses:</p> <p>2.1. fails to meet initial capital and own funds requirements as established in this Law and by the CBK;</p> <p>2.2. violates any requirement concerning the safeguarding of funds as provided for in Articles 11 and 33 of this Law;</p> <p>2.3. has failed to establish adequate and comprehensive audit arrangements required under paragraph 2 of Article 12 and paragraph 1 of Article 29 of this Law;</p> <p>2.4. does not notify the CBK on any major developments as laid down in Article 17;</p>	<p>drugog podzakonskog akta koje je izdala CBK za njegovu primenu, kao što je predviđeno ovim članom, smatraće se administrativnim prekršajem i CBK ima ovlašćenje da izriče kazne platnoj službi, provajdera, institucije elektronskog novca ili drugih relevantnih fizičkih ili pravnih lica utvrđenih u narednim stavovima ovog člana.</p> <p>2. CBK izriče kaznu od 500 do 25.000 evra za pružaoca platnih usluga ili instituciju elektronskog novca koja počini bilo koji od sledećih prekršaja:</p> <p>2.1. ne ispunjava zahteve za početni kapital i sopstvena sredstva kako je utvrđeno ovim zakonom i CBK-om;</p> <p>2.2. krši bilo koji zahtev koji se odnosi na čuvanje sredstava kako je predviđeno članovima 11. i 33. ovog zakona;</p> <p>2.3. nije uspostavila adekvatne i sveobuhvatne mehanizme revizije zahtevane prema stavu 2. člana 12. i stavu 1. člana 29. ovog zakona;</p> <p>2.4. ne obaveštava CBK-a o bilo kom većem razvoju događaja kao što je navedeno u članu 17;</p>
---	---	--

<p>2.5. nuk mban llogaritë kontabël dhe/ose nuk përgatit pasqyrat financiare për pasqyrimin e saktë të gjendjes financiare, në përputhje me rregullat e parimet kontabël, siç përcaktohet në Nenin 19 të këtij Ligji;</p> <p>2.6. nuk raporton sipas formës, tipit, metodologjisë, përmbajtjes dhe afateve të përcaktuara nga BQK-së;</p> <p>2.7. jep kredi lidhur me shërbimet e pagesave, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4 të Nenit 20 dhe nënparagrafin 1.2 të Nenit 32 të këtij Ligji;</p> <p>2.8. ofron shërbimet e pagesave nëpërmjet agjentëve, pa njoftuar BQK-në, siç përcaktohet në paragrafin 1 të Nenit 21 të këtij Ligji;</p> <p>2.9. nuk e informon BQK-në për kontraktimin e funksioneve operacionale, siç përcaktohet në paragrafin 5 të Nenit 21 të këtij Ligji;</p> <p>2.10. ngarkon me tarifë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për dhënien e informacionit, në kundërshtim me Nenin 40 të këtij Ligji;</p> <p>2.11. nuk i siguron përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin e</p>	<p>2.5. does not maintain accounts and/or does not prepare financial statements to reflect their financial condition precisely and in accordance with the accounting rules and principles as laid down in Article 19 of this Law;</p> <p>2.6. does not report according to the form, type, methodology, content and reporting periods as determined by the CBK;</p> <p>2.7. grants credit relating to payment services, in violation of the requirements laid down in paragraph 4 of article 20 and subparagraph 1.2 of Article 32 of this Law;</p> <p>2.8. provides payment services through an agent, without informing the CBK, as laid down in paragraph 1 of Article 21 of this Law;</p> <p>2.9. does not inform the CBK on the outsource of operational functions as provided for in paragraph 5 of Article 21 of this Law;</p> <p>2.10. charges the payment service user on providing information in violation of paragraph 1 of Article 40 of this Law;</p> <p>2.11. does not provide to the payment service user any of the information</p>	<p>2.5. ne vodi račune i/ili ne priprema finansijske izveštaje koji odražavaju njihovo finansijsko stanje precizno i u skladu sa računovodstvenim pravilima i principima kako je utvrđeno u članu 19. ovog zakona;</p> <p>2.6. ne izveštava u skladu sa formom, vrstom, metodologijom, sadržajem i periodima izveštavanja koje je odredio CBK;</p> <p>2.7. odobrava kredite u vezi sa platnim uslugama u suprotnosti sa zahtevima iz stava 4. člana 20. i podstava 1.2. člana 32. ovog zakona;</p> <p>2.8. pruža platne usluge preko posrednika, bez obaveštavanja CBK-a, kao što je predviđeno stavom 1. člana 21. ovog zakona;</p> <p>2.9. ne obaveštava CBK-a o eksternalizaciji operativnih funkcija kao što je predviđeno u stavu 5. člana 21. ovog zakona;</p> <p>2.10. tereti korisnika platnih usluga za davanje informacija u suprotnosti sa stavom 1. člana 40. ovog zakona;</p> <p>2.11. ne pruža korisniku platnih usluga nijednu informaciju koja se traži prema</p>
--	--	---

<p>kërkuar nën Pjesën III ose ofron informacionin e pakompletuar apo mashtrues në kundërshtim me kërkesat e neneve 42, 44 deri 49, 51 deri 53 të këtij Ligji;</p> <p>2.12. ngarkon me tarifë përdoruesin e shërbimeve të pagesave në rastin e ndërprerjes së kontratës kornizë, në kundërshtim me Nenin 55 të këtij Ligji;</p> <p>2.13. refuzon në mënyrë të paarsyeshme ekzekutimin e urdhërpagesës ose nuk e njofton përdoruesin e shërbimeve të pagesave, siç përcaktohet në nenet 78 dhe 79 të këtij Ligji;</p> <p>2.14. i ndalon përdoruesin e shërbimeve të pagesave mundësinë e kthimit të urdhërpagesës, siç përcaktohet me Nenin 80 të këtij Ligji;</p> <p>2.15. nuk transferon shumën e plotë të transaksionit të pagesës, siç përcaktohet në paragrafin 1 të Nenit 81 të këtij Ligji ose në rastet kur palët kanë rënë dakord për zbritjen e tarifave nga shuma e transferuar, nuk informon përfituesin e pagesës për shumën e plotë të transaksionit të pagesës dhe tarifat e zbritura, siç përcaktohet në paragrafin 2 të Nenit 81 të këtij Ligji;</p> <p>2.16. shkelë kufizimet kohore të përcaktuara me nenet 82 dhe 87 mbi</p>	<p>required under the Section III or provides the information in an incomplete or deceitful manner in violation of the requirements set forth in Articles 42, 44 to 49, 51 to 53 of this Law;</p> <p>2.12. charges the payment service user in case of framework contract termination, in violation of Article 55 of this Law;</p> <p>2.13. unreasonably refuses the execution of a payment order, or does not notify the payment service user as prescribed in Article 79 of this Law;</p> <p>2.14. prevents the payment user from revoking a payment order as prescribed in Article 80 of this Law;</p> <p>2.15. does not transfer the full amount of the payment transaction, as laid down in paragraph 1 of Article 81 of this Law, or in the event the parties have agreed on deducting charges from the transferred amount, does not inform the payee on the full amount of the payment transaction and the deducted charges, as set forth in paragraph 2 of Article 81 of this Law;</p> <p>2.16. violates the time limits prescribed in Articles 83 to 87 of this Law, on</p>	<p>Odeljku III ili pruža informacije na nepotpun ili lažan način kršeći uslove utvrđene u članovima 42, 44. do 49, 51. do 53. ovog zakona;</p> <p>2.12. tereti korisnika platnih usluga u slučaju raskida okvirnog ugovora, u suprotnosti sa članom 55. ovog zakona;</p> <p>2.13. neopravdano odbija izvršenje naloga za plaćanje, ili ne obaveštava korisnika platnih usluga u skladu sa članom 79. ovog zakona;</p> <p>2.14. sprečava korisnika plaćanja da opozove nalog za plaćanje u skladu sa članom 80. ovog zakona;</p> <p>2.15. ne prenosi puni iznos platne transakcije iz stava 1. člana 81. ovog zakona, ili u slučaju da su se strane dogovorile o odbijanju troškova od prenesenog iznosa, ne obaveštava primaoca plaćanja o punom iznosu platne transakcije i odbijene naknade, kako je navedeno u stavu 2. člana 81. ovog zakona;</p> <p>2.16. krši rokove propisane članovima 83. do 87. ovog zakona o vremenu</p>
--	--	---

